

## Politikat e Privatësisë

I nderuar vizitor,

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, përmes këtij dokumenti informon se çfarë të dhënash mbledh, përpunon, përhap, ruan dhe masat e sigurisë që merr për të dhënat personale që deklarohen nga ana juaj, përmes faqes zyrtare pro edhe pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Të gjithë vizitorët që aksesojnë faqen zyrtare – [www.ild.al](http://www.ild.al) duhet të bien dakord me këtë politikë. Nëpërmjet hyrjes në këtë faqe interneti, konsiderohet se keni lexuar dhe pranuar kushtet e përdorimit të kësaj faqe interneti, e cila përbën “Politikën e Privatësisë”. Jeni të lutur të mos vijoni të aksesoni dhe të lundroni në faqen zyrtare nëse nuk jeni dakord me këtë politikë. Në të kundërt, do të konsiderohet se e keni pranuar këtë politikë.

Rubrikat e faqes zyrtare kanë për qëllim rritjen e transparencës dhe realizimin e komunikimit dhe ndërveprimit në kohë reale me çdo subjekt të interesuar e duke mundësuar efektivitetin, efikasitetin dhe në një nivel sa më afër publikut. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj faqe web, çdo individ mund të aksesojë informacion të përgjithshëm dhe të dhënat përkatëse të koordinatorit për të drejtën e informimit në formën më të përshtatshme dhe brenda një kohe sa më të arsyeshme.

### Lloji i të dhënave personale dhe përdorimi i tyre

Lloji i të dhënave personale që administrohen pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë:

- a) të dhënat personale të subjekteve të hetimit disiplinor, konkretisht gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm;
- b) të dhënat personale të punonjësve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- c) të dhënat personale të ankuesve;
- d) të dhënat personale të vizitorëve;
- e) të dhënat personale të personave të interesuar gjatë një procedure rekrutimit.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në faqen zyrtare në rubrikën “formulari i ankesës”, mundëson për publikun plotësimin e formulari të ankesës, në formatin “*word*” dhe në formatin “*online*”.

Gjatë plotësimit të formularit, në cilindo format, kërkohet dhënia e të dhënave personale. Këto të dhëna, nuk komunikohen me palë të tjera, por përcillen në mënyrë të automatizuar tek punonjësit përgjegjës për trajtimin e ankesave në adresën [info@ild.al](mailto:info@ild.al). Plotësimi i rubrikave të formularit kërkohet vetëm për qëllime të ligjshme dhe në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Formatin në *word*, mundëson dërgimin nga ankuesit me postë, me e-mail (tek adresa [info@ild.al](mailto:info@ild.al)) ose me dorëzim fizik pranë mjediseve të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në pjesën e fundit të formularit, mundësohet plotësimi i deklaratës së konfidencialitetit me anë të së cilës Inspektori i Lartë i Drejtësisë, merr përsipër të mos përdorë dhe të mos i transmetojë personave të paautorizuar të dhëna personale apo informacione konfidenciale në lidhje me ose të marra nga ankuesi, përveç nëse autorizohet shprehimisht nga ky i fundit, ose kërkohet me ligj. Ky detyrim vlen për çdo fazë të shqyrtimit të ankesës.

Në rubrikën njoftime, gjenden të renditura disa nënrubrika, të cilat kanë në përmbajtje të tyre të dhëna personale, të cilat depozitohen nga aplikantët dhe informacione të gjeneruara në kuadër të procedurave verifikuese dhe akte të hartuara në përfundim të procedurave përzgjedhëse të rekrutimit. Aktet e hartuara përmbajnë emrin e aplikantit dhe rezultatet e procedurave verifikuese ku përmenden të gjitha korrespondencat shkresore me institucionet kompetente. Të gjitha aktet e hartuara dhe publikuara janë administruar në përputhje me kërkesat dhe procedurat ligjore për rekrutimin e tyre.

Krahas të dhënave të personale të përcaktuara në dy rubrikat e faqes zyrtar, të dhënat personale mund të administrohen edhe përmes postës apo përmes paraqitjes fizike pranë mjediseve të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Këto të dhëna personale përdoren për të komunikuar me subjektet e hetimit disiplinor, organet kompetente shtetërore në kuadër të verifikimit, ankuesit, vizitorët dhe personat e interesuar për procedura rekrutimi. Qëllimi i përpunimit të të dhënave personale për:

- ✓ subjektet e hetimit disiplinor është përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga Kushtetuta, ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr 115/2016 “Për organet e sistemit të qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- ✓ përpunimin e të dhënave personale të punonjësve të Inspektorit të Lartë Drejtësisë për efekt të krijimit të marrëdhënies së punës dhe përmbushjes së detyrimeve për administrimin e dosjes personale të punonjësve;
- ✓ trajtimit të ankesës lidhur me pretendime për shkelje disiplinore nga ana e subjekteve të hetimit referuar legjislacionit specifik procedural, si edhe atij material mbi statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë;
- ✓ ruajtjen dhe mbrojtjen e personelit, dokumentacionit dhe pronës në administrim të institucionit;
- ✓ përpunimin në kuadër të procedurave të rekrutimit.

Të dhënat personale që japin ankuesit, punonjësit e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vizitorët, personat që kanë interes për procedurat e rekrutimit, apo çdo subjekt i interesuar, përdoren vetëm për përmbushjen e qëllimeve të dhënies së këtyre të dhënave dhe në kryerjen e detyrave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi që rregullon veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe në zbatim të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë mënyrën e përpunimit të të dhënave personale. Inspektori i Lartë i Drejtësisë komunikon të dhënat personale, vetëm nëse nevojiten për qëllim të rasteve kur kërkohen nga organet ligj zbatuese për nevoja të hetimit dhe zbulimit të veprës penale, duke respektuar kërkesat e ligjit nr.9987, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Punonjësit e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i nënshtrohen detyrimit për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit i cili i jepet këtij të fundit për të ushtruar funksionet e tij në bazë të ligjit, dhe mund t’a përhapë atë vetëm pranë autoriteteve shtetërore që kanë në kompetencë përpunimin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë disponon faqen [www.ild.al](http://www.ild.al). nëpërmjet së cilës mbledh informacione standarde të cilat kanë të bëjnë me klikimet e rubrikave në këtë faqe. Ky informacion mblidhet për qëllime statistikore dhe studimi për të parë se cilat janë rubrikat interes për vizitorët e faqes, pa i bërë ata të identifikueshëm.

## **Mbrojtja e të dhënave personale**

Mbrojtja e të dhënave personale bazohet në:

- a. përpunimin në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme;
- b. grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime;
- c. mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
- d. mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar;
- e. saktësinë që të dhënat duhet të kenë dhe, kur është e nevojshme, duhet të përditësohen, duke ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për të fshirë apo korrigjuar të dhëna të pasakta apo të paplota, në lidhje me qëllimin për të cilin janë mbledhur.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr përsipër të mbrojtë dhe të mos keqpërdorë për asnjë rast këto të dhëna.

Në përfundim të qëllimit të përpunimit të të dhënave personale, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i ruan të dhënat sipas legjislacionin në fuqi, që rregullon afatet specifike të përpunimit dhe ruajtjes së tyre. Të dhënat personale që mbahen në sistemet elektronike, në rast se nuk ka një detyrim ligjor për ruajtjen e tyre, fshihen, në momentin që ato nuk janë më të nevojshme për qëllimin për të cilin janë mbledhur në mënyrë të ligjshme nga ana e prokurorisë. Çdo tre vjet, vendos për domosdoshmërinë e mbajtjes së të dhënave personale ose fshirjen e tyre, pas vlerësimit të kryer nga përgjegjësit e strukturave që administrojnë këto të dhëna.

## **Siguria**

Inspektori i Lartë i Drejtësisë siguron çdo përdorues që të dhënat që mbërrijnë në adresë tij, janë të siguruar nga tërësia e masave organizative dhe teknike për mbrojtjen, ruajtjen, sigurinë dhe administrimin e të dhënave personale. Njëkohësisht Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përkushtuar në zbatimin me rigorozitet të të gjithë kuadrit ligjor në mbrojtje dhe respektim të çdo veprimi që lidhet me të dhënat e përdoruesve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar si dhe çdo akti tjetër të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Përpunimi i të dhënave personale në lidhje me shërbimet që ofrohen nëpërmjet internetit nga kjo faqe administrohet nga stafi teknik përgjegjës për përpunimin e të dhënave. Asnjë informacion që rezulton nga shërbimi nëpërmjet internetit nuk komunikohet ose shpërndahet përveç rasteve kur informacioni kërkohet nga organet kompetente që e fitojnë këtë të drejtë me ligj të veçantë, në respektim dhe përputhje me këto kërkesa.

## **E drejta për t'u ankuar**

Çdo person, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë Komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Pas këtij ankimi, subjekti i të dhënave mund të ankohet në gjykatë, në përputhje me parashikimet e kuadrit ligjor në fuqi.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale:

Adresa: Rruga "A. Toptani", Kati II-të.

[www.idp.al](http://www.idp.al)

Në rast se subjekti i të dhënave ka bërë ankim, kontrolluesi nuk ka të drejtë të ndryshojë të dhënat personale deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

### **Pyetje/Ankesa/Informacion**

Me anë të informacionit të mësipërm shpresojmë t'ju kemi informuar në mënyrë të plotë rreth çështjeve të privatësisë, në funksion të përdorimit të faqes zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për çdo kërkesë, informacion apo problematikë të mundshme në lidhje me faqen web: [www.ild.al](http://www.ild.al), lutemi të na kontaktoni në:

E-mail: [info@ild.al](mailto:info@ild.al).

Tel: +355 42217217

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13, Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë 1001, Shqipëri